VENDIM
Nr.985, datë 1.12.2010

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË KATIT PËRDHE TË NDËRTESËS SË SPITALIT INFEKTIV, ELBASAN, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR FUNKSIONIMIN E FAKULTETIT TË INFERMIERISTIKËS, TË UNIVERSITETIT "ALEKSANDËR XHUVANI", ELBASAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të katit përdhe të ndërtesës së Spitalit Infektiv, Elbasan, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për funksionimin e Fakultetit të Infermieristikës të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i ndalohet të ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë apo t'ua japë në përdorim të tretëve pronën e përcaktuar në këtë vendim.
3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANIMETRIA E KATIT PERDHE (SPIT INFERMIU)
RIKONSTRUKSION
SHKALLA 1:200